



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
REKTORATI

Nr. 582 Prot

Gjirokastrë, më 09 / 04 /2019

N J O F T I M

Njoftohen të gjithë studentët e Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastrë se duke filluar nga data **16 Prill 2019 deri në 02 Maj 2019,** do të zhvillohet **Sondazhi Kombëtar i Studentëve**, i cili organizohet nga Agjensia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë.

Sondazhi Kombëtar i Studentëve është një proces i cili ka si qëllim kryesor vlerësimin dhe matjen e cilësisë në arsimin e lartë duke vlerësuar performancën e IAL-ve në veprimtarinë e mësimdhënies, mësimnxënies dhe kompetencave dhe mbështetjes ndaj studentëve.

Ky sondazh është i rëndësishëm të plotësohet nga të gjithë ju dhe të shprehni mendimin e tuaj të pavarur rreth IAL-së ku keni zgjedhur të studioni.

Ky pyetësor zhvillohet online, në adresën elektronike të secilit prej jush do të dërgohet një link i personalizuar për secilin student. Pas klikimit të këtij linku do tju shfaqet pyetësori online.

Plotësimi i këtij pyetësori është **anonim** dhe bazohet tërësisht në opinionin individual të secilit prej jush.

Universiteti "Eqrem Çabej" vë në dispozicioni tuaj ambientet me akses interneti dhe bazë materiale të nevojshme (kompjuterë) si mëposhtë :

1. Laboratori i Informatikës Godina B kati i III
2. Salla Multi Media Room , Godina A kati i II
3. Qendra e Këshillimit të Karrierës / ALUMNI Godina C kati i III

Këto ambiente do të jenë në dispozicionin tuaj nga ora 08.00 deri në orën 16.00 gjatë gjithë periudhës që do të zhvillohet sondazhi.

Për çdo informacion shtesë apo paqartësi , Ju lutemi drejtoheni pranë zyrës së Standarteve dhe Kurrikulave.

Duke ju falenderuar !

REKTORATI
I
UNIVERSITETIT "EQREM ÇABEJ"